



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3049/ 12 Prot.,

Datë 18.12.2025

V E N D I M
Nr. 1881 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.12.2025 shqyrtoi ankesën me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Auto Manoku Servis” ShPK dhe “Servis-Auto 2000” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-62708-09-25-2025, me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit, me fond limit 7.782.350 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.10.2025 nga autoriteti kontraktor Albcontrol Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Vilnik Motors” ShPK, me Nipt L01314031G, Adresa: Rr. Kavajë, Vaqar, Lalm, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Albcontrol Sh.A.
Adresa: Aeroporti “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” ShPK, me Nipt L62311016C, Adresa: Rr. Nozllaku, Godinë 2 kate, Kati 1, Z. Kadastrale 3866, Nr. Pasurie 287/28 , Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “Servis-Auto 2000” ShPK, me Nipt K31523078F, Adresa: Rr. Enriko Telini, Nd. 15, H. 1, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues legjitimohet të paraqitë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 26.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, Shërbime, me Nr. REF-62708-09-25-2025, me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit, me fond limit 7.782.350 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.10.2025 nga autoriteti kontraktor Albcontrol Sh.A.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 13.10.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në SPE dhe ka kryer renditjen e tyre si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1- Auto Manoku Servis ShPK	5.836.762,50	Kualifikuar
2- SERVIS - AUTO 2000 ShPK	6.559.000,00	Kualifikuar
3- VILNIK MOTORS ShPK	6.970.720,00	Kualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti Kontraktor më datë 22.10.2025, ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4 Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6014, datë 28.10.2025 dhe me Nr. 3049/2025 Prot., datë 28.10.2025, nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*” Shërbime, me Nr. REF-62708-09-25-2025, me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit, me fond limit 7.782.350 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.10.2025 nga autoriteti kontraktor Albcontrol Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Auto Manoku Servis” ShPK dhe “Servis-Auto 2000” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 3049/1 prot., datë 29.10.2025, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.6. Me shkresat, ardhur në sistem me Nr. 2885 Prot., datë. 12.11.2025, protokolluar me tonën me Nr. 3049/2, datë 10.11.2025, si edhe me shërbim postar, me Nr. 2885 Prot., datë. 12.11.2025, protokolluar me tonën me Nr. 3049/3, datë 13.11.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së për mospranim të ankesës.

II.7.Me vendimin e ndërmjetëm me Nr. 1799/2025, datë 04.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit, kopje të noterizuar të tyre, nga ana e subjektit “Servis-Auto 2000” SHPK, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit, të dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar” Shërbime, me Nr. REF-62708-09-25-2025, me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit, me fond limit 7.782.350 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.10.2025 nga autoriteti kontraktor Albcontrol Sh.A.*
2. *Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 11.12.2025.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.8. Me shkresën me nr. 3049/4 prot., datë 04.12.2025, me objekt: Kërkesë për dërgim dokumentacioni, drejtuar autoritetit kontraktor, Komisionit të Prokurimit Publik, referuar pretendimeve të ngritura në ankesë, i lind nevoja të shqyrtojë dokumentacionin e plotë të

dorëzuar në mënyrë shkresore pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, i renditur i pari.

II.9. Me shkresën me Nr. 3140/1 prot., datë 11.12.2025, protokolluar me tonë me Nr.3049/8, datë 11.12.2025, Autoriteti kontraktor ka përcjellë dokumentacionin provues të operatorit ekonomik i renditur i pari «Auto Manoku Servis» ShPK.

II.10. Me shkresën me Lista e dokumenteve, datë 10.12.2025, protokolluar me tonë me Nr.3049/9, datë 11.12.2025, operatori ekonomik “Servis Auto 2000” ShPK, ka përcjellë dokumentacionin provues të ofertës së tij në procedurën objekt shqyrtimi.

II.11. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nuk ka pretendime nga operatorë të interesuar për këtë procedurë prokurimi objekt shqyrtimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimesit mbi operatorin ekonomik “Servis-Auto 2000” ShPK me argumente si vijon:

- Ne lidhje me pikat B,C,D,E , ky Operator Ekonomik nuk disponon dëshmitë e aftësisë profesionale sipas profesioneve të kërkuara, pasi ka paraqitur dëshmi të përgjithshme për të gjithë personelin që disponon.

Ne kriterin 2.1.1 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorist
- c) 1 (një) xhenerik
- d) 1 (një) pompist
- e) 1 (një) elektroauto

Në lidhje me punonjësin në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale
- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës.

Për secilin prej punonjësve në pikat (b, c, d, e) më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.1. Autoriteti kontraktor me shtojcën 9, Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, ka kërkuar:

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorist
- c) 1 (një) xhenerik
- d) 1 (një) pompist
- e) 1 (një) elektroauto

Në lidhje me punonjës në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale
- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës.

Për secilin prej punonjësve në pikat (b, c, d, e) më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit

III.1.2 Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.3. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përsa kohë i kanë pranuar ato dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i ankesës në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik Servis-Auto 2000 ShPK në procedurën e prokurimit vëren, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues kanë të bëjnë me mosplotësimin e kriterit kualifikues 2.1.1 në lidhje me përmbushjen e pikave **b),c),d)** dhe **e)** mbi disponimin e dëshmimeve të aftësisë profesionale sipas profesioneve të kërkuara me argumentin se kanë dëshmi të përgjithshme për të gjithë personelin.

III.1.5. Komisioni, në referim të pretendimeve të ngritura në ankesë, me Vendimin e Ndërmjetëm me Nr. 1799/2025, datë 04.12.2025, vendosi: “Paraqitjen e dokumentacionit, kopje të noterizuar të tyre, nga ana e subjektit “Servis-Auto 2000” ShPK, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit, të dokumenteve të procedurës së prokurimit.”.

Me shkresën “Lista e dokumenteve”, datë 10.12.2025, protokolluar me tonë me Nr.3049/9, datë 11.12.2025, operatori ekonomik “Servis Auto 2000” ShPK, ka përcjellë dokumentacionin provues të ofertës së tij në total 1562 faqe, për procedurën objekt shqyrtimi.

Komisioni mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë për mosplotësim të Kriterit 2.1.1 pikat b),c),d) dhe e), ku kërkohet:

Për secilin prej punonjësve në pikat **(b, c, d, e)** më sipër duhet të paraqitet:

- **kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës.**
- **Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas ligjit Nr.15/2017, « Mbi arsimin dhe formimin profesional », i ndryshuar.**

Operatori ekonomik “Servis Auto 2000” ShPK, në përmbushje të kriterit për kualifikim, 2.1.1, për të cilët ankimuesi ngre pretendime ka paraqitur dokumentet si vijon:

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar në të gjitha pjesët, në tërësi të tij dhe në veçanti në:

Pjesa III, Kriteria e përzgjedhjes, Deklarata për disponimin e punonjësve dhe Makinerive të nevojshme. Profili i punojësve:

- | | |
|-----------|--|
| 1. Sh. Xh | Inxhinier Mekanik, Drejtues teknik, Administrator. |
| 2. A. Ll | Xhenerik |
| 3. Q. S | Motorist |
| 4. E. L | Lamarinist-bojatisje |
| 5. K. B. | Pompist |
| 6. A. N | Xhenerik |
| 7. A. C | Elektroauto |

Dokumentet provuese të dorëzuara për personelin si vijon:

Deklaratë: Listpagesa të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatim mbi të Ardhurat për 10 punonjës.

Dokumente : **Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës dhe**

Kontrata pune, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës listuar në vijim:

1. Sh. Xh Inxhinier Mekanik, Drejtues teknik, Administrator.
 - Diplomë, nr.2070, Lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, dega Mekanikë Inxhinier Mekanik për Makineri.
 - Dëshmi Aftësimi Profesional me Nr. 154 prot., datë 31.01.2017, nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, Ministria e Transportit Rrugor.
(riparim mirembajtje pjesë mekanike dhe motorri, karrocieri, impiante elektrike, blerje-shitje mjete motorrike dhe rimorkio, mbledhje depozitim shakterrim mjete rrugore jashtë përdorimi.)

2. A. Ll. Xhenerik

- Dëshmi Kualifikimi, me Nr. amze 120, datë 10.04.2013, Lëshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional Publik nr. 4 Tiranë, Ministria e Punës e çështjeve sociale, Komisioni i testimit të DRFPP, për Z. A. Ll, ka mbaruar Kursin Autoservis, me vlerësim A.

- Kontratë Individuale Pune, me kohëzgjatje të pacaktuar e lidhur me dt. 04.01.2022. Në pozicion Xhenerik, proceset e punës janë- kontroll dhe konstatim difekte, Zëvendësim pjesë xhenerike të automjeteve.

Firmosur nga palët dhe vulosur nga punëdhënësi.

3. A. C. Elektroauto

- Dëshmi Kualifikimi, me Nr. amze 116, datë 10.04.2013,

Lëshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional Publik Nr. 4 Tiranë, Komisioni i testimit të DRFPP, për Z.A. C, ka mbaruar Kursin Autoservis, me vlerësim A.

- Kontratë Individuale Pune, me kohëzgjatje të pacaktuar e lidhur me dt. 04.01.2022. në pozicioni Elektroauto proceset e punës janë-kontroll, diagnostikim me kompjuter. Riparim i sistemit elektrik te automjeteve.

Firmosur nga palët dhe vulosur nga punëdhënësi.

4. Qamil Selita Motorist

- Diplomë, nr.2059, Lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, dega Mekanikë

për Z. Q. S, Inxhinier mekanik për makineri.

- Kontratë Individuale Pune, me kohëzgjatje të pacaktuar e lidhur me dt. 04.01.2022, ne pozicion motorrist, proceset e punës janë-riparim motorri te automjeteve, vendosje ne faze te automjeteve.

Firmosur nga palët dhe vulosur nga punëdhënësi.

5. E. L, Lamarinist-Bojatisje

- Çertifikatë e Kursit të Veçantë, me nr. amze 834, datë 05.07.2022,

Lëshuar nga Drejtoria e Formimit Profesional Publik nr. 1 Tiranë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për E. L, Kurs i veçantë për Lamarinist-Bojatisje, me rezultat provimi përfundimtar 10.

- Kontratë Individuale Pune, me kohëzgjatje të pacaktuar e lidhur me dt. 02.05.2023, ne pozicion llamarinist dhe bojaxhi per automjete, proceset e punës janë- lysterje me boje te gjitha automjetet, punime të llamarines dhe kalibër për karambole te automjeteve.

Firmosur nga palët dhe vulosur nga punëdhënësi

6. A. N, Xhenerik

- Çertifikatë Matura Shtetërore Profesionale, për Z. A. N. Lëshuar nga Shkolla Profesionale Beqir Çela, Durrës.

(Njohuri mjetet transporti, shërbim mjete transporti, edhe elektrike Shërbim motorri, diagnostikim për mjete transtorti, axhustim, punime mekanike, sistem drejtimi,etj).

- Kontratë Individuale Pune, me kohëzgjatje të pacaktuar e lidhur me dt. 08.01.2025, ne pozicion xhenerik, proceset e punës-zmontim-montim dhe riparim te pjeseve te automjeteve.

Firmosur nga palët dhe vulosur nga punëdhënësi.

7. K. B., Pompist

- Certifikatë e Kursit të Unifikuar me Nr. amze 007-000333, datë 27.09.2024,

Lëshuar nga Qendra e Formimit Profesional Publik nr. 1 Tiranë, Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Komisioni i testimit të DRFPP, për Z. K. B, ka mbaruar Kursin e Unifikuar Profesional Automekanik, me vlerësim përfundimtar 9. (Punime Motorri, automjeteve te lehta, Sistemin e drejtimit, Sistem transmissioni, Sistem frenimi, Sistemi elektrik, Sistemi ecjes dhe varjes).

- Kontratë Individuale Pune, me kohëzgjatje të pacaktuar e lidhur me dt. 10.04.2025, ne pozicion pompist, me procese pune-riparim te pompave elektrike, riparim te pompave mekanike.

Firmosur nga palët dhe vulosur nga punëdhënësi

Dokumentacioni i listuar më sipër është kopje e noterizuar.

III. 1.6. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit provues nga operatori ekonomik “Servis Auto 2000” ShPK mbi përmbushje të kriterit 2.1.1. pikat b/c/d/e/ për punonjësit:

- b) 1 (një) motorist
- c) 1 (një) xhenerik
- d) 1 (një) pompist
- e) 1 (një) elektroauto

Për secilin prej punonjësve në pikat **(b, c, d, e)** më sipër duhet të paraqitet:

- **kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i kontratës.**
- **Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas ligjit Nr.15/2017, « Mbi arsimin dhe formimin profesional », i ndryshuar.**

Operatori ekonomik ka paraqitur kopje te noterizuara:

-Të kontrave të punës të vlefshme, ku janë specifikuar për secilin punonjës sipas kriterit 2.1.1 listuar në nënpikat b, c, d, e , ku janë përcaktuar pozicionet specifike, detyrat dhe proceset e punë specifike për të gjithë të punësuarit. Sipërcituar në pikën III. 1.5.

-Të Dëshmimeve të aftësimin profesional, nga Qendra të Formimit Profesional, sipas programeve të miratuara nga Ministria përgjegjëse, për secilin punonjës të deklaruar në përmbushje të kriterit 2.1.1. Cituar në pikën III.1.5.

Komisioni në analizë të fakteve gjykon se operatori ekonomik “Servis Auto 200” ShPK me dokumentacionin provues dorëzuar pranë Komisionit, përmbush kriterin kualifikues 2.1.1. Mbi personelin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi operatorin ekonomik “Servis-Auto 2000” ShPK me argumente si vijon:

Në lidhje me përmbushjen e Kriterit 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergencës) së rrotave të mjetit;
- b) Pajisje bango provë, për motorino dhe alternator (dinamo);
- c) Pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete;

- d) Pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- e) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit;
- f) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit;
- g) Pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v;
- h) Pajisje urë ngritëse për automjetet, të paktën 3 (tre) ura ngritëse për mjetet objekt prokurimi;
- i) Pajisje për pastrimin nga brenda të motorit me H₂;
- j) Pajisje për pastrimin e marmitave katalitike DPF;
- k) Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorit;**
- l) Pajisje për kontrollin, riparimin & kalibrimin e turbinave të motorit;**
- m) Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- n) Pajisje për zëvendësimin e vajit të motorit;
- o) Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- p) Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet;
- q) Pajisje për saldime me oksigjen & argon & saldime elektrik;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

-Dokumenta që vërtetojnë se këto pajisje i ka aktualisht në pronësi ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje/dokumente zhdoganimi/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje kontratë dhurimi/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkojnë sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Ne lidhje me këto kriter kualifikimi ky Operator Ekonomik nga të gjitha pajisjet e kërkuara nuk disponon këto pajisje:

k) Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorit;

l) Pajisje për kontrollin, riparimin & kalibrimin e turbinave të motorit;

Pavaresisht dokumentacionit të paraqitur për disponimin e këtyre pajisjeve.

III.2. 1 Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit për kualifikim, 2.3.4 (për të cilin ankimesi ngre pretendime), operatori ekonomik “Servis Autor-2000” ShPK ka paraqitur dokumentet si vijon:

Deklaratë mbi Agregatat/Pajisjet/Pjesë Këmbimi të reja me garanci nga prodhuesi.

Dokumenti Lista e Inventarit të pajisjeve dhe makinerive të Servis Auto 2000 ShPK, Firmosur dhe vulosur nga Administratori.

Referuar pretendimeve mbi mangësi të dokumenteve kualifikues për **pikën 2.3.4/ k) Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorit;** Operatori ekonomik ka paraqitur:

Faturë Tatimore me Nr. 42, datë 22.07.2020, Blerës Servis Auto 2000 ShPK

Shites SI&Co Company, Përshkrimi i mallit: **Pajisje për kontroll, presion cilindrave dhe testatave të motorit.**

Ne përmbushje të pikesë 2.3.4/l) Pajisje për kontroll dhe riparim & kalibrim të turbinave.

Operatori ekonomik ka paraqitur:

Faturë tatimore nr. 1/2025, date 01.02.2025, Blerës Servis Auto 2000 ShPK Shites SI&Co Company , Pershkrimi i mallit: ***Pajisje për riparim dhe Kalibrim Turbine.***

Komisioni në shqyrtim të dokumenteve provuese në përmbushje të kriterit kualifikues 2.3.4 gjykon se operatori ekonomik “Servis Auto-2000” ShPK përmbush kriterin kualifikues 2.3.4 për pikat k) dhe l) objekt ankimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi operatorin ekonomik “Servis-Auto 2000” ShPK me argumente si vijon:

Per kriterin 2.3.5.Operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Leja e qarkullimit të mjetit, Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për automjetet, foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika përkatëse. *Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Ky Operator Ekonomik nuk e ploteson kete kriter pasi duhet te kishte paraqitur dokumentacionin justifikues “Per transport Mallrash per te Trete dhe me Qira brenda Vendit”

III.3.1. Autoriteti kontraktor në Shtojcën 9, ka kërkuar Kriterin 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- **dokumentacion për mjetin** në pronësi, ose **me qera**, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / **kontrata qiraje** / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Leja e qarkullimit të mjetit, Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për automjetet, foto të mjeteve ku të duket qartë targa dhe sinjalistika përkatëse

III.1.2. Komisioni mori në shqyrtim dokumentacioni provues të operatorit ekonomik “Servis Auto-2000” ShPK nga ku konstaton, se në përmbushje të kriterit për kualifikim, 2.3.5 (për të cilin ankimuesi ngre pretendime), operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet si vijon:

KONTRATË QIRAJE
(Pasuri të Luajtshme)

Nr. Rep. 69,

Nr.Kol. 16,

Tiranë me 17.03.2025

Lidhur midis Qiradhënësit G. Sh, dhe Qiramarrësit Shoqëria “Servis Auto-2000” ShPK si me poshte

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Objekti i kontraktimit: Qiradhënësi disponon automjetin me te dhënat e mëposhtme, sipas dokumentacionit bashkangjitur kësaj kontrate, te cilat ja jep me qira Qiramarrësit:

1.Karrotrec per transport Automjetesh:

Nr.	Përshkrimi	Te dhënat e Automjetit
1	Lloji/Marka	IVECO FIAT DAILY D1
3	Numri i identifikimit	ZCFC35C2005910708
4	Targa	AB 475 EJ
5	Viti i prodhimit	2012

Kontrata lidhet për një periudhë 6 vjecare, bashkelidhur saj gjenden dokumentet si vijon

Leje Qarkullimi nga DPSHTRR

-Policë për Sigurimin e detyrueshëm të mbajtësit të mjeteve motorrike per përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

-Certifikatë e Kontrollit teknik të Mjeteve Rrugore.

-Kontrata firmosur nga palët e lidhur në prani të noterit.

-Dy fletë me pamje të mjetit ku identifikohet marka IVECO dhe targa AB 475 EJ

Përsa konstatuar më sipër nga shqyrtimi i dokumenteve provuese në përmbushje të kriteri kualifikues 2.3.5, *operatori ekonomik të disponoje minimalisht 1 (një) karrotrec, për transportimin e automjeteve të difektuara:*

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet: dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje, ...

Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Servis Auto-2000” ShPK me dokumentacionin e dorëzuar përmbush kriterin për 2.3.5 të kriterëve kualifikuese në procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” ShPK, mbi mosplotësim të kriterëve kualifikues 2.1.1, 2.3.4 dhe 2.3.5 nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” ShPK i renditur i pari, si edhe bazuar në gjykimin e marrë në pikat III.1 e vijim, III.2 e vijim dhe III.3 e vijim të këtij vendimi Komisioni ka vendosur mospranim të pretendimeve mbi skualifikim të operatorit ekonomik “Servis Auto-2000” i renditut në vend të dytë, I cili do të mbetet i kualifikur pas vendimmarrjes së KPP-së.

Për sa arsyetuar Komisioni gjykon të mos marrë në shqyrtim pretendimet e tjera të ankimesit për faktin se, edhe në rastin hipotetik të pranimit të tyre, operatori Vilnik Motors ShPK nuk ka mundësi të fitojë kontratën pasi ndodhet në vend të tretë në renditjen përfundimtare të operatorëve ekonomikë të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” ShPK” në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Shërbime, me Nr. REF-62708-09-25-2025, me objekt: Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit, me fond limit 7.782.350 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 07.10.2025 nga autoriteti kontraktor Albcontrol Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” ShPK
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fioorent Zguro

